



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura III**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 08

Prishtinë, më 08 mars 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 225

**P R O C E S V E R B A L**

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

**Në mbledhje morën pjesë:** Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Adem Salihaj, Armend Zemaj, Mufera Şinik, Kolë Berisha, Selvije Halimi dhe Radmila Vujoviq.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Albulena Ademi dhe Afërdita Syla - NDI, Teuta Rexhepi – Bota Sot, Behlul Zeka – EULEX, Shenbane Voca dhe Isuf Zejna – KDI.

**Nga Staf i Komisionit:** Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni, Sulltane Gashi dhe Visar Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 1 mars 2010,
3. Shqyrtimi i Projektkodit të drejtësisë për të mitur,
4. Shqyrtimi i Planit të veprimit të grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për faljen,
5. Përgatitjet për dëgjimin publik të Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
6. Të ndryshme.

**Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi ditës u miratua pa ndryshime.*

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 01 mars 2010**

**Kryetari** konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 01 mars 2010, pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i Projektkodit të drejtësisë për të mitur**

**Kryetari** - E përshëndeti Radmila Vujoviqin, e cila është caktuar anëtare e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Në vazhdim tha se ka qenë hap shumë i rëndësishme i Komisionit për legjislacion dhe Gjyqësi që e kemi monitoruar Ligjin penal për të mitur. Edhe ekspertet nga vendet e ndryshme evropiane, që në forma të ndryshme kanë monitoruar këtë ligj, ishin të befasuar me rekomandimet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, si të sakta dhe mjaft përmbajtjesore. Shumica e rekomandimeve që i ka nxjerrë Komisioni janë inkorporuar në Projektkodin e drejtësisë për të mitur. Propozoi që për shqyrtimin e këtij projektkodi të mbahet një tryezë, ku do të ftohen institucionet që konsiderohen se janë me interes për shqyrtimin e tij. Meqë nuk është prezent përfaqësuesi OSBE – së - ishte i gatshëm të mbështeste realizimin e kësaj tryeze - do të ishte me interes t'i ftojme kryetarët e komisioneve parlamentare ose dikush nga anëtarët e komisioneve, përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Prokurorisë, Gjyqësisë, Shërbimi korrektues i Kosovës, Shërbimin Sprovues, Qendra për Punës Sociale dhe nga Policia. Propozoi të formohet dhe një nënkomision dhe të caktohen ekspertë që të angazhohen nga Komisioni.

**Adem Hajdaraj** - Propozoi që në këtë tryezë të ftohet edhe deputeti Riza Smaka.

**Adem Salihaj** - Tha se do të ishte me interes ata të cilët ftohen në Tryezë të vijnë me propozime konkrete të shkruara.

**Kryetari** konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

### **PËRFUNDIM**

*Formohet nënkomisioni me këtë përbërje: Bahri Hyseni, Ibrahim Makolli, Kolë Berisha dhe Radmila Vujoviq.*

*Ekspertët që do të angazhohen nga Komisioni janë: Ismet Kabashi, Genc Nixha, Muhamet Kelmendi, Metije Ademi dhe Fllanza Kadiu.*

### **4. Shqyrtimi i Planit të veprimit të grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për faljen**

**Kryetari** - E ftoi Ibrahim Makollin ta njoftoi Komisionin me Planin e veprimit rreth monitorimit të Ligjit për faljen.

**Ibrahim Makolli** - Para Komisionit paraqiti Planin e veprimit, hartuar nga nënkomisioni i caktuar për monitorimin e Ligjit për faljen. Paraqiti pikat që i cilësoi si shumë të rëndësishme; e para Komisioni të kërkojë listën e personave që kanë parashtruar kërkesë për falje, listën e personave që kanë përfituar nga falja dhe kriteret mbi të cilat është bërë falja. Vizitë Zyrës së Presidentit është paraparë të jetë më 22 mars.

Në vazhdim tha se Ministria e Drejtësisë është e ndërlidhur me këtë çështje, sepse ajo e bën mbledhjen e informatave për personat që kanë bërë kërkesë për faljen. Vizita në ministri është paraparë më 26 mars, ndërsa më 16 prill vizitë në burgun e Dubraves. Përpilimi i raportit është paraparë deri më 30 prill.

**Kryetari** tha se do të ishte mirë të shikohet se si është bërë vlerësimi nga Komisioni, i cili paraprakisht i shqyrton kërkesat për faljen.

**Ibrahim Makolli** - Duke u ndërlidhur me parafolësin sqaroi se me Ligjin për faljen nuk parashihet asnjë Komision, i cili paraprakisht i shqyrton kërkesat për falje. Të gjitha kërkesat i drejtohen presidentit. Ju referua neneve 6 dhe 7 të Ligjit për faljen, shqyrtimi i kërkesave për faljen dhe vendimi mbi kërkesën për faljen.

**Adem Salihaj** - Tha se nëse kërkesat shqyrtohen nga një organ, që nuk e dimë se a e formon presidenca, që do të bëjë vlerësim për kërkesat që janë shtruar, si Komision duhet t'i shohim se si janë bërë ato vlerësime. Presidenca kërkon vetëm informata nga ministria, nuk kërkon vlerësime. Rreth vizitës në burgun e Dubraves tha se duhet të përpilojmë një listë se personat të cilët do t'i vizitojmë, paraprakisht të njoftohet drejtoria, në mënyrë që vizita të ketë sukses. Na duhet lista nga burgu, lista nga Ministria e Drejtësisë, si dhe lista e personave që kanë përfituar nga falja dhe do t'i krahasojmë.

**Armend Zemaj** - Theksoi se monitorimin e këtij ligji po e bëjmë se sa po zbatohet dhe cilat janë vështirësitë. Në vazhdim ceku se çdo të burgosuri i dërgohet formulari për të bërë kërkesë për falje, ndërsa lidhur me atë se a ka Komision në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë ose Zyrës së Presidentit për vlerësimin e kërkesave, se a e respektojnë ligjin, ne do ta shohim gjatë vizitës që do ta bëjmë, por nuk mund të paragjykojmë. Ne me këtë plan kemi paraparë t'i shohim listat nga burgu, lista nga Ministria e Drejtësisë, si dhe lista që kanë përfituar nga falja dhe do t'i krahasojmë se si janë bërë vlerësimet.

**Ramadan Gashi** - E përkrahu Planin e veprimit. Në vazhdim dha sqarime rreth procedurave që zbatohen, si dhe mundësinë eventuale që nëse ekzistojnë Komisione të tilla, të shikohet se si i kanë vlerësuar kërkesat për faljen.

**Adem Salihaj** Në fjalën e tij të sërishme propozoi që paraprakisht të jemi të përgatitur dhe t'i kërkojmë listat nga tri nivelet: burgu, ministria dhe presidenca; t'i kërkojmë se kush i ka bërë vlerësimet dhe t'i kemi me shkrim të dhënat që i ka dërguar Ministria e Drejtësisë, nëse i ka kërkuar presidenti, në mënyrë që të jemi të përgatitur gjatë realizimit të vizitave.

**Kryetari** konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

### **PËRFUNDIM**

*Komisioni e përkrahu Planin e veprimit për monitorimin e Ligjit për faljen, duke i përcaktuar datat e realizimit të vizitave në Zyrën e Presidentit, në Ministrinë e Drejtësisë dhe në Burgun e Dubraves.*

#### **5. Përgatitjet për dëgjimin publik për Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale**

**Kryetari** i njoftoi se dëgjimi publik do të mbahet më 09. 03. 2010 dhe do të ishte mirë që t'i kemi edhe rekomandimet që i ka nxjerrë Komisioni nga takimi më 10 shtator 2009.

**Armend Zemaj** - Shtoi se pasi ky është dëgjim publik do të ishte mirë që të mos marrim shumë kohë, sepse, si anëtarë të Komisionit, mund të bëjmë ndonjë pyetje eventuale, por jo të lëshohemi në komente.

**Kryetari** propozoi të formohet një nënkomision dhe të caktohen ekspertët për shqyrtim të mëtejshëm të Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

**Kryetari** konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

### **PËRFUNDIM**

*Formohet nënkomisioni me këtë përbërje: Armend Zemaj, Adem Salihaj, Selvije Halimi, dhe Mufera Sinik.*

*Ekspertët që do të angazhohen nga Komisioni janë: Bajram Ukaj dhe Sokol Zogaj.*

#### **6. Të ndryshme.**

Lidhur me këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 14:50

**E përgatiti:**  
**Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Bahri Hyseni**